



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

---

Numri i lëndës: 2023:276178

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05721095

**K.DH.SH.II.nr.467/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë**, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit KRU “Hidromorava” SH.A., me NUI:811339979, me seli në Gjilan, Rr. “Vëllezërit Gërvalla” p.n., kundër debitorit Kryqi i Kuq, me seli në Kamenicë, Rr. “Skenderbeu” p.n, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.1141/22 të dt. 16.11.2023, me datë 22.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Kryqi i Kuq, me seli në Kamenicë, Rr. “Skenderbeu” p.n., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale „Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.1141/22 të dt. 16.11.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1141/22 të dt. 16.11.2023, e ka hedhur poshtë si të paafatshëm prapësimin e debitorit Kryqi i Kuq, i ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.410/21 i datës 12.11.2021, i Përbaruesit Privat Kushtrim M. Musa.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa dhe të detyrohet kreditorit që përpos shpenzimeve të mëhershme që përfaqësuesi i të autorizuarës së debitorit t’ia kompensoje edhe shpenzimet konform tarifës së OAK-së për hartimin e ankesës.

Përgjigje në ankese nuk ka parashtruar kreditori.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Prapësimi i debitorit është i pa afatshëm.

Përmbauesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.410/2021 të datës 12.11.2021, duke lejuar përmbauesin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës së datës 30.09.2021, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,714.77 €, si dhe të gjitha shpenzimet tjera procedurale, në të kundërtën organi përmbaues do të bllokoj të gjitha llogaritë bankare të debitorit deri në pagimin e shumës totale të detyrimit, ndërsa nëse debitori nuk ka mjete të mjaftueshme në llogari bankare, atëherë zbatimi të zbatohet në tërë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori ka parashtruar prapësim përmes të cilit e kundërshton urdhrin përmbaues, ndër të tjerash ka theksuar se kreditori asnjëherë nuk i ka ofruar ndonjë marrëveshje për pagesën e shërbimeve, apo faturë lidhur me shpenzimet e krijuara dhe atë jo nga Kryqi i Kuq por nga një uzurpues i objektit të quajtur A. D.. Nga vitit 2008 Kryqi i kuq në Kamenicë nuk e ka selinë në objektin kontestues ku edhe janë krijuar shpenzimet e ujit. Ka shtuar se sikur kreditori të kërkonte borxhin e vet me kohë ne kemi qenë të gatshëm ti përgjigjemi pozitivisht, duke njoftuar se ne nuk i krijojmë shpenzimet por dikush tjetër. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj urdhrin përmbaues dhe të detyrohet kreditori që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim si të pa bazuara dhe nuk përmbajnë asnjë nga kushtet e parapara në nenin 71 të LPPsë, sepse fatura e datës 30.09.2021 dhe kartela e konsumatorit kodi 19874, është në emër të debitorit në bazë të të cilave është bazuar propozimi për përmbaues të cilat janë dokument i besueshëm – tituj ekzekutiv dhe atë konform nenit 29 par.1 nën par.1.2 dhe 1.3 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin KPPP.nr.1141/22 të dt. 16.11.2023, e ka hedhur poshtë si të paafatshëm prapësimin e debitorit Kryqi i Kuq, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbaues P.nr.410/21 i datës 12.11.2021, i Përmbauesit Privat Kushtrim M. Musa.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 e as neni 183 të LPK, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbauesore përcaktohet së: *“Prapësimi duhet të dorëzohet gjykatës brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të vendimit përmbaues ose urdhrin përmbaues”,* ndërsa me dispozitën e nenit 73 paragrafi 3, parashihet së: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i*

*palejuar*?. Ne rastin konkret rezulton se debitori urdhrin përmbarimor P.nr.410/21 të datës 12.11.2021, e ka pranuar me datën 17.11.2021, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 18.11.2021 rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 24.11.2021. Andaj, Kjo gjykate vlerëson se meqë debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 18.11.2021, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, dhe rrjedhimisht prapësimi i debitorit është i pa afatëshëm.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 25.11.2021, në zyrën e përmbaruesit privat, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar edhe në mënyra tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me një ditë vonesë.

Në këtë kontekst dhe në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata e shkalles se dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjërisht ka vendosur kur e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit, sepse në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se debitori me datë 17.11.2021 e ka pranuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 859/23, të lejuar më datë 12.11.2021, nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, fakt ky i cili vërtetohet nga fletë-kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat e cila gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 18.11.2021 rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 24.11.2021, ndërsa debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 25.11.2021 rezulton se prapësimi është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore te debitorit nga ana e Gjykatës së shkalles se dytë, por nuk janë konsideruar të rëndësishme për të vendosur ndryshe sepse debitori nuk ka mundur ti provoj pretendimet e tij ankimore për afatshmërinë e prapësimit, as për shkaqet e pengesave për paraqitjen e ankesës brenda afatit.

Kompetenca e Gjykatës për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkalles se Dytë**  
**K.DH.SH.II nr.467/24, me datë 22.05.2024**

**Gjyqtari,**  
**Ramush Bardiqi**